

Mission ynë:

Mbështetja e mundësive për përmirësimin e arsimimit të fëmijëve dhe të rinjëve të rajonit të neglizhuar të Malësisë së Madhe të Shqipërisë së Veriut.

President: Steve Cook, PhD

Secretary: Terri Cook

Albania Manager: Marash Rakaj

Executive Dir: Kristina Milaj

Board of Directors:

Mary Alice Seville
Nancy Leeper
Mona Jones-Romansic
Jennifer Gervais

Albanian Alps Institute
8600 NW Oak Creek Drive
Corvallis, OR 97330

Phone: 541-230-1285
Email: albanianalpsinst@gmail.com
Website: www.albanianalps.org

Nga Presidenti

Viti i kaluar nisi me pak shqetësim për mua, pasi nuk munda të shkoj në Shqipëri për shkak të skadimit të datës në pasaportën time. Edhe pse pasaporta skadonte pas kthimit tim nga Shqipëria, rregulli (për të cilin nuk isha në dijeni) thotë se duhet të skadojë tre muaj ose më shumë pas kthimit tim. Këtë e mësova ditën e nisjes. Për fat të keq, ne nuk ishim në gjendje të sponsorizojm konkursin vjetor të shkollave, megjithatë, viti që kaloi ishte i suksesshëm për programet tona.

Ne kemi zgjeruar donacionet tona në dy shkolla të tjera në ish-komunen Shkrel. Shkollat e fshatrave Reç dhe Zagorë marrin tani mjetet mësimore për kopshtin dhe librat e bibliotekës nga AAI. Studentët nga këto dy fshatra tashmë kanë të drejtë të aplikojnë për bursa universitare. Në fshatin Vukel, të zonës së Kelmendit, po mundohemi të hapim një kopsht fëmijësh. Megjithatë, po hasim në vështirësi për të gjetur një mësues/e, sepse njerëzit e kualifikuar kanë tendencë të largohen nga fshati, por ne vazhdojmë të kërkojmë një mësues/e kopshtit për fshatin Vukel.

Në tetor, ne mirëpritëm një anëtare të re të bordit, Jen Gervais, e cila ka pranuar bujarisht të dhurojë kohën dhe njohuritë e saja për drejtimin e organizatave jofitimprurëse për AAI-n.

Dua të përgëzoj personalisht Marin Malotaj, student i shkëlqyer i bursës AAI. Marini përfundoi i dyti në një provim pranues jashtëzakonisht konkurrues në programin e Masterit të Inxhinierisë në Universitetin e Tiranës. Bravo, Marin! Ne jemi të gjithë krenarë për ju.

Në shtator, Sekretarja e AAI-t, Terri Cook organizoi një festë, për njëzet vjetorin e themelimit të AAI-it, në një punishte vere lokale pranë Corvallis. Pati një pjesmarrje shumë të mirë dhe ishte kënaqësi të shihje mbështetësit e AAI-t, përfshirë edhe shumë mbështetës të vjetër të AAI-t. Më poshtë keni disa foto nga festa.

Faleminderit juve, donatorëve, që keni bërë të mundur vazhdimin e mbështetjes sonë për mundësitë arsimore në këtë cep të vogël të botës.

Steve Cook, President



Aplikantët për bursa për vitin shkollor 24-25

Denisa Pepaj	Matematikë/Informatikë	Master	Viti i pestë	Vrith
Ernest Gjellaj	Matematikë	Master	Viti i katërt	Vukel
Marin Malotaj	Inxhinieri civile	Master	Viti i katërt	Bzhetë
Rozalba Malotaj	Fizioterapi	Bachelor	Viti i tretë	Bzhetë
Anjeza Mitaj	Infermieri	Bachelor	Viti i dytë	Selcë
Denada Pepaj	Biologji & Kimi	Bachelor	Viti i parë	Vrith
Desara Volaj	Psikologji	Bachelor	Viti i parë	Brojë
Leonida Naçaj	Fizioterapi	Bachelor	Viti i parë	Kozhnje

FËMIJËT E KOPSHTIT




MIRËSEVJEN ANËTARJA JONË E RE E BORDIT JENNIFER GERVAIS

Jeni është një ekologe e kafshëve të egra që ka punuar për shumë vite për një organizatë të vogël jofitimprurëse të fokusuar në ruajtjen dhe menaxhimin e kafshëve të egra. Ajo tani punon në komunikimin për rrezikun e pesticideve në Qendrën Kombëtare të Informacionit për Pesticidet. Ajo ka një jetë të tërë në edukimin informal shkencor. Interesat e tjera përfshijnë punimin e tokës që



zotëron me burrin e saj, dhe çdo aktivitet për sa kohë që është jashtë, dhe punon me qentë e saj të verbër dhe të shurdhër. Ajo shpreson të japë një kontribut thelbësor në drejtimin e AAI-t në vitet e ardhshme dhe mbështetje për pjesën tjetër të ekipit.

MBLEDHJE FONDESH



AAI bashkëpunoi me Fondacionin Ndërkombëtar Altrusa të Corvallis për të drejtuar një nga standat e koncesionit Grab n Go në lojërat e futbollit pranë OSU-s. Ne jemi shumë mirënjohës për këtë mundësi. Në foton më sipër janë Kristina Milaj, Drejtore Ekzekutive dhe vëllai i saj Bernard Milaj. Një falenderim të madhe për Bernardin për përpjekjet e tij vullnetare. Ai ka punuar pothuajse në të gjitha ndeshjet për ne.



Dua t'ju falënderoj për mbështetjen që më keni dhënë prej vitësh. Bursa do të thotë shumë për mua, duke marrë parasysh shpenzimet e një studenti dhe vendin ku jetoj. Me bursën që mora nga AAI e kisha më të lehtë të blija libra, të paguaja transportin dhe qiranë.
Denisa Pepaj



Unë jam shumë mirënjohës për bursën që kam marrë nga ju, kjo është një ndihmë e madhe për mua sepse kostoja e shtëpive me qira, librat dhe tarifatat e shkollës janë të larta. Falënderit shumë!
Ernest Gjellaj

